

GJATË VITIT 2024...

- *Ekonomia shqiptare pati një vit pozitiv zhvillimi, të karakterizuar nga norma të ulëta inflacioni, rritje të qëndrueshme ekonomike dhe përmirësime në tregun e punës, të pasqyruara në rritjen e punësimit dhe të pagave krahasuar me një vit më parë. Gjithashtu, treguesit kryesorë të ekuilibrave ekonomike e financiarë të vendit u përmirësuan, siç dëshmohet, ndër të tjera, nga ulja e borxhit të jashtëm dhe atij publik, si dhe nga niveli i ulët i deficitit të llogarisë korrente.*
- *Vendi njohu një përmirësim të dukshëm në vlerësimin e borxhit publik nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit, duke ndikuar në uljen e kostove të financimit në tregjet e huaja, si për sektorin publik ashtu edhe për atë privat.*
- *Politika monetare, e orientuar drejt përmbushjes së objektivit të stabilitetit të çmimeve, ndoqi një qasje lehtësuese gjatë vitit 2024. Kontributi i saj u materializua në kontrollin e pritjeve për inflacionin, uljen e pasigurive dhe përmirësimin e mjedisit financiar. Në reflektim të saj, kostot e kreditimit u reduktuan dhe kredia u rrit me ritme të shpejta, e mbështetur gjithashtu nga rritja e kërkesës dhe qasja pozitive e bankave ndaj kreditimit.*
- *Sistemi financiar, dhe në veçanti sektori bankar, shënoi përmirësim në treguesit e likuiditetit, kapitalizimit dhe cilësisë së kredisë. Rreziqet sistemike në sistemin financiar vlerësohen të jenë të kontrolluara, ndërsa qëndrueshmëria e sektorit bankar ndaj goditjeve potenciale mbetet e fortë. Shëndeti i mirë dhe qëndrueshmëria e sektorit bankar i mundësojnë një rol efektiv në ndërmjetësimin financiar dhe në mbështetjen e ekonomisë.*
- *Banka e Shqipërisë ka vijuar me përafrimin e mëtejshëm të kuadrit rregullator me acquis e BE-së, forcimin e kuadrit të politikës makroprudenciale, si dhe rritjen e kapaciteteve për ndërhyrje të jashtëzakonshme. Gjatë vitit, u rishikua kuadri rregullator për mbrojtjen e konsumatorëve nga rreziku i paaftësisë për shlyerjen e detyrimeve, duke siguruar që kredimarrësit të kenë mundësi të përballojnë detyrimet financiare, pa cenuar nevojat e tyre thelbësore.*
- *Viti 2024 shënoi një moment historik jo vetëm për Bankën e Shqipërisë, por edhe për vendin. Më 21 nëntor, Këshilli Evropian i Pagesave vendosi të përfshijë Shqipërinë në zonën gjeografike të Tregut Unik të Pagesave në Euro (SEPA), një hap i rëndësishëm ky drejt integritimit financiar me tregun evropian.*
- *Përdorimi i sistemeve të procesimit të pagesave u rrit ndjeshëm, ndërsa përmirësimet rregullatore dhe infrastrukturore në këtë fushë kanë nxitur adoptimin e instrumenteve elektronike të pagesave, duke rritur efikasitetin dhe aksesin në shërbimet financiare.*
- *Si një nga institucionet kyçe të vendit, Banka e Shqipërisë ka mbështetur procesin e integritimit evropian të Shqipërisë, duke përmbushur të gjitha detyrimet për raportim dhe duke integruar rekomandimet e Komisionit Evropian në veprimtarinë e saj të përditshme.*



- Në fillim të vitit 2024, Banka e Shqipërisë miratoi Strategjinë për Edukimin dhe Përfshirjen Financiare, dokumentin e saj të parë institucional që synon promovimin e edukimit financiar, zgjerimin e përfshirjes financiare dhe nxitjen e mirëqenies dhe qëndrueshmërisë ekonomike.
- Banka e Shqipërisë ka intensifikuar komunikimin me publikun shqiptar përmes medias dhe platformave online, duke u udhëhequr nga parimet e transparencës dhe llogaridhënies.

